



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 7605/prot.
3

Tiranë, më 6 . 12 .2019

VENDIM

Nr. 97, datë 6.12.2019

PËR

ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHORTIT TË DATËS 16 DHJETOR 2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mbështetje të Kushtetutës, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, si dhe të pikës 8 dhe 9 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” miratuar me vendimin nr. 50, datë 18.10.2019, pas rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të datës 20.11.2019 dhe 5.12.2019, në mbledhjen e datës 6.12.2019, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pezullimin e shortit të datës 15 dhjetor 2019, të përcaktuar sipas germës “a” të pikës 6 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Shorti i parashikuar sipas pikës 8 të nenit 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” për datën 11.12.2019, miratuar me vendimin nr. 86, datë 25.11.2019, të Komisionit, të zhvillohet ditën e hënë, datë 16 dhjetor 2019, ora 16:00, në sallën e mbledhjeve të godinës së Komisionit.
3. Njoftimin për pjesëmarrje të vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4. Publikimin e kësaj liste në faqen zyrtare të institucionit pas hedhjes së shortit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Genta Tafa (Bungo)

